

VENDIM
Nr. 435, datë 8.6.2016

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 1374, DATË 10.10.2008,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE DHE TË
PROCEDURAVE, QË NDIQEN PËR HEQJEN, SHTIMIN DHE NDRYSHIMIN E
DESTINACIONIT TË FONDIT KULLOSOR”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 4, të nenit 10, të ligjit nr. 9693, datë 19.3.2007, “Për fondin kullor”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mjedisit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 1374, datë 10.10.2008, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Në të gjithë vendimin bëhen ndryshimet e mëposhtme:
 - a) emërtimi “organe të qeverisjes vendore” zëvendësohet me “bashki”;
 - b) emërtimi “Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave” zëvendësohet me “Ministria e Mjedisit”;
 - c) emërtimi “Drejtori Rajonale e Shërbimit Pyjor” zëvendësohet me “struktura përgjegjëse për pyjet dhe kullotat në bashki”;
 - ç) termi “kullotë komunale” zëvendësohet me “kullotë bashkiake”.
2. Pas shkronjës “c”, të pikës 6, shtohet shkronja “d”, me këtë përmbajtje:

“d) Miratimin me shkrim për vazhdimin e procedurave të heqjes nga fondi kullor nga ana e kryetarit të bashkisë, brenda territorit administrativ të të cilit është sipërfaqja kullorë e cila do t’i nënshtrohet procedurave të heqjes nga fondi kullor.”.
3. Pika 7 ndryshohet si më poshtë vijon:

“7. Ministria, pas depozitimit të kërkesës, i kërkon strukturës përgjegjëse për pyjet dhe kullotat në bashki, identifikimin e ngastrave dhe të nënngastrave të kërkuara dhe hartimin e raportit teknik për to, brenda 1 jave nga marrja e kërkesës. Ky raport i përcillet ministrisë brenda 10 ditëve nga data që ajo e ka kërkuar.”.
4. Pika 12 ndryshohet si më poshtë vijon:

“12. Vlera e sipërfaqes kullorë të hequr dhe e infrastrukturës së saj paguhet nga kërkuesi para hyrjes në fuqi të aktit të miratimit, të përmendur në shkronjat “a” e “b”, të pikës 9, të këtij vendimi, dhe derdhet në llogarinë bankare të bashkisë brenda territorit administrativ të të cilit është sipërfaqja kullorë, e cila do t’i nënshtrohet procedurave të heqjes nga fondi kullor.”.
5. Pika 17 ndryshohet si më poshtë vijon:

“17. Kur kërkesa bëhet sipas përcaktimit në pikën 15, ajo shqyrtohet nga Ministria e Mjedisit brenda 30 (tridhjetë) ditëve. Pas këtij afati, ajo quhet e miratuar. Struktura përgjegjëse për pyjet dhe kullotat në bashki dhe ministria bëjnë përditësimet në kadastrën e pyjeve.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Niko Peleshi